



Prishtinë, 24 janar 2018

Komunikatë për media

ZRRE diskuton situatën e energjetike në vend me përfaqësues të KfW

Sot përfaqësues të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), kanë pritur në takim përfaqësuesit e Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW), Z. Renè Eschemann, shef i zyrës së KfW në Kosovë dhe zëvendësen e tij Znj. Ganimete Huruglica, me qëllim të informimit për gjendjen e përgjithshme të sektorit të energjisë në vend, në veçanti me zhvillimet e fundit në sektor.

Përfaqësuesit e KfW janë interesuar për qëndrimet e Rregullatorit, sidomos për gjendjen financiare të operatorit të Sistemit të Transmisionit (KOSTT), pas vendimit të Gjykatës për mos pranimin e humbjeve të shkaktuara nga furnizimi në veri të vendit.

Ushtruesi i detyrës së Bordit të ZRRE, Z. Arsim Janova, ka sqaruar për përfaqësuesit e KfW, se pas vendimit gjyqësor, për humbjet e energjisë në veri të vendit, ZRRE nuk do të mund të pranoj humbjet e shkaktuara në veri, si humbje të arsyeshme. Në lidhje me këtë vendim, Z. Janova tha se ZRRE është e vetëdijshme për pasojat financiare dhe me këtë qëllim ka njoftuar edhe institucionet me të larta vendore, në mënyrë që të gjendet një zgjidhje e cila nuk do të dëmtonte stabilitetin financiar të operatorëve dhe sistemin energjetik në vend.



Edhe përfaqësuesit e KfW kanë shprehur brengën se qëndrueshmëria financiare e operatorëve përveç që është faktor kryesor në stabilitetin e furnizimit të qytetarëve me energji elektrike, po ashtu është tregues i mbarëvajtjes së shumë projekteve të mbështetura nga donatorët dhe institucionet financiare ndërkombëtare siç është edhe KfW.

Z. Janova ka potencuar rëndësinë e madhe të mbështetjes së donatorëve për sektorin e energjisë dhe në veçanti ndihmën e KfW dhënë për KOSTT-in, duke shprehur besim se institucionet e vendit do të gjejnë zgjidhje për trajtimin e humbjeve dhe tejkalimin e vështirësive në të cilat ndodhet sektori.